

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7945  
E enjte, 5 dhjetor 2024  
Çmimi 0.50 €

## SBASHK-u proteston për rritje pagash dhe kontratën kolektive



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# OSMANI E KURTI NË BRUKSEL E SHTROJNË SI TEMË SULMIN E FUNDIT NË VERI

FAQE 4-5



Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti gjatë takimit që patën ndaras me presidentin e Këshillit Evropian, Antonio Costa, kanë diskutuar edhe për zhvillimet në fushën e sigurisë, përfshirë sulmin e fundit terrorist në

infrastrukturën vitale të Kosovës në kanalin e Ibër-Lepencit, sulm ky që kishte për qëllim që të linte një pjesë të madhe të qytetarëve të Kosovës pa ujë, pa energji elektrike, pa ngrohje dhe me pengesa në sistemin e

telekomunikimit. Dy zyrtarët shtetërorë të Kosovës kanë shprehur gatishmërinë e plotë të institucioneve të vendit për bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar për hetimin e aktit terrorist kundër infrastrukturës vitale në Kosovë

## DJALI I JAKUP KRASNIQIT I BASHKOHET PDK-së, GARON PËR DEPUTET NË ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

F. 3



## KUSHTET E PUNËS TE SEKTORI PRIVAT, PROBLEMATIKE MBESIN PËSHIMET VJETORE DHE AI I LEHONISË

F. 5



## OPINION

### VARRAGA APO VRRAGA E KOSOVËS

F. 5

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



### NATO-ja PAJTOHET TA BËJË PRIORITET MBROJTJEN E INFRASTRUKTURËS SË UKRAINËS

F. 2

### "K'CIMI I TROPOJËS" MBROHET NGA UNESCO

F. 6

### SHSKUK-JA DHE FAKULTETI I MJEKËSISË NISIN HAPAT PËR BASHKËPUNIM

F. 6

## EKONOMI



### KOSOVA DHE MBRETËRIA E ARABISË SAUDITE NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE DOGANORE

F. 6

## SPORT



### UEFA DËNON QIPRON E 10 MIJË EURO PËR BANERIN 'KOSOVA ËSHTË SERBI'

F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...

# NATO-ja pajtohet ta bëjë prioritet mbrojtjen e infrastrukturës së Ukrainës

**BRUKSEL, 4 DHJETOR** - Vendet anëtare të NATO-s janë pajtuar ta bëjnë prioritet të lartë mbrojtjen e infrastrukturës së Ukrainës, tha të mërkurën shefi i aleancës ushtarake, Mark Rutte.

Rusia është duke i bombarduar paseshtur qytetet dhe qytezat ukrainase me raketa dhe dronë. Duke folur për gazetare para ditës së dytë të takimit të ministrave të Jashtëm të 32 vendeve anëtare të NATO-s, Rutte tha se gjatë takimit është biseduar për t'i dhënë Ukrainës sisteme të mjaftueshme për mbrojtje ajrore në mënyrë që ajo ta mbrojë infrastrukturën e vet nga sulmet ruse. "Pati pajtueshmëri të qartë mbrëmë se mbështetja e Ukrainës,

posaçërisht për infrastrukturën e saj, duhet të jetë prioritet", tha Rutte. "Besoj se aleatët do të sigurohen në ditët dhe javët në vazhdim se do ta furnizojnë Ukrainën me çfarëdo që mund ta furnizojnë", tha ai.

Ky është dimri i tretë radhazi që Rusia e sulmon infrastrukturën energjetike të Ukrainës dhe, si pasojë, ka shkakuar viktima dhe ka penguar furnizimin me energji elektrike për mijëra civilë.

Mëngjesin e së mërkurës dronë rusë sulmuan rajonin verior të Çernihivit, duke dëmtuar disa shtëpi në një fshat, tha guvernatori rajonal Vyacheslav Chaus në "Telegram". Në rajonin qendror të



Vinnitsyas, mbetjet e një droni të rrëzuar shkaktojnë zjarr në një shtëpi në distriktin Haisin, duke e shkatërruar pjesërisht atë, tha Shërbimi i

Emergjencave të Ukrainës. Ndërkohë, Forca Ajrore e Ukrainës raportoi se Rusia përdori një raketë dhe 50 dronë ndaj objektivave në Ukrainë.

Mbrojtja ajrore e Ukrainës i rrëzoi 29 dronë në nëntë rajone - Kiev, Harkiv, Poltava, Sumi, Çernihiv, Hmelnitki, Ternopil, Mikolaiv dhe Donjeck, tha ajo. Ndërkohë, shpërthime të fuqishme u raportuan gjatë natës në portin rus të Detit të Zi, Novorossiisk, i cili është nga qendrat kryesore për eksportet ruse të naftës dhe port i rëndësishëm ushtarak për një pjesë të flotës ruse të Detit të Zi. Sirena ajrore u lëshuan në këtë pjesë dhe kryetari i Novorosiskut, Andrei Kravchenko, u bëri thirrje banorëve të strehohen për shkak të një sulmi me dron. As Ukraina e as Rusia nuk kanë komentuar ende mbi shpërthimet.

## Trazira në Gjeorgji, policia akuzohet për brutalitet kundër protestuesve

**TBILISIT, 4 DHJETOR** - Policia gjeorgjiane përdori përsëri gaz lotsjellës dhe topa uji për t'i shpërndarë protestuesit mëngjesin e së mërkurës në kryeqytetin Tbilisi, duke nxitur bashkësinë ndërkombëtare, përfshirë një grup ligjvënësish amerikanë me ndikim, t'i dënojnë veprimet e saj.

Në natën e gjashtë radhazi të protestave në kryeqytetin gjeorgjian, demonstruesit u zhvendosën nga qendra Rustaveli Avenue në një stacion metroje aty pranë, pasi forcat e sigurisë ua bllokuan hyrjen në ndërtesën e Parmanetit dhe i arrestuan disa prej tyre.

Gjeorgjia është tronditur nga protestat prej kur partia në pushtet, Ëndrra Gjeorgjiane, njoftoi javën e kaluar se do t'i pezullojë bisedimet për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian. Pavarësisht prej protestave në rritje, kryeministri Irakli



Kobakhidze nuk ka pranuar të zbrapset dhe ka kërcënuar se do t'i ndëshkojë kundërshtarët politikë të cilët i akuzon për dhunën që ka ndodhur gjatë protestave.

Forcat e sigurisë filluan t'i shpërndajnë demonstruesit që ishin mbledhur para ndërtesës së Parlamentit, pasi Ministria e Brendshme deklaroi se disa prej tyre kishin fyer oficerët e zbatimit të ligjit dhe kishin

hedhur sende të forta, fishekzjarrë dhe lëndë të ndezshme në drejtim të tyre. Tre senatorë amerikanë me ndikim - bashkëkryetari i Komisionit të Helsinkit në ShBA, senatori Ben Cardin (demokrat nga Meriland), Roger Wicker (republikan nga Misisipi) dhe John Cornyn (republikan nga Teksasi), lëshuan një komunikatë të përbashkët në mbështetje të

protestuesve gjeorgjianë dhe dënuan përdorimin e tepruar të dhunës nga qeveria. "Vendimi i Ëndrrës Gjeorgjiane për t'i braktisur negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian është një tradhti e madhe ndaj dëshirës së qartë dhe të madhe të popullit gjeorgjian për t'i përqafuar vlerat dhe institucionet evropiane", thanë tre senatorët. "Kjo nuk është sjellja e një qeverie të angazhuar për reforma demokratike dhe pluralizëm, por e një regjimi të pasigurt që po e tërheq Gjeorgjinë drejt një autokracie në stilin rus. Këto veprime shkelin hapur normat demokratike ndërkombëtare dhe minojnë aspiratat legjitime të popullit gjeorgjian", thuhej në komunikatë. Protestuesit kanë rrëfyer për Radion Evropë e Lirë brutalitetin e ushtruar nga forcat e sigurisë kundër tyre. "Ata na godisnin në kokë", tha

protestuesja Salome Zandukeli, duke përkrahur se si ajo dhe një mik u ndoqën natën e 2 dhjetorit nga rreth 25 policë në një ndërtesë në qendër të Tbilisit, para se të strehoheshin në një kafene.

Aktivisti Gia Jvarsheishvili i tha Radios Evropë e Lirë se ai u hodh në tokë nga policët që sulmonin dhe u rrah para se të futej me forcë në një furgon policie, ku të arrestuarit u detyruan të shtriheshin dhe u shtypën me këmbë nga policia. Presidentja proevropiane e Gjeorgjisë, Salome Zurbishvili, e cila ua mban anën demonstruesve, tha në platformën X se shumë nga protestuesit e arrestuar kishin plagë në kokë dhe fytyrë. Disa prej tyre u rrahën sistematikisht gjatë arrestimit dhe transportimit në qendrat e ndalimit, shtoi ajo. Avokati i popullit i Gjeorgjisë e akuzoi policinë për torturimin e protestuesve pro-BE-së.

## Erdogani bisedon me Putinin për konfliktin në Siri

**ANKARA, 4 DHJETOR** - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, dhe ai i Rusisë, Vladimir Putin, kanë shprehur nevojën për më shumë diplomaci për zgjidhjen e konfliktit në veri të Sirisë, gjatë një bisede telefonike që zhvilluan më 3 dhjetor pas rinisjes së luftimeve.

Sipas njoftimit për medie të lëshuar nga zyra e Erdoganit, udhëheqësi turk tha se Siria nuk duhet të shndërrohet në burim të paqëndrueshmërisë së madhe. "Presidenti Erdogan theksoi se përderisa Turqia vazhdon ta mbështesë

integritetin territorial të Sirisë, po ashtu kërkon një zgjidhje të drejtë dhe të përhershme në Siri", i tha Erdogan Putinin gjatë bisedës telefonike, tha zyra e udhëheqësit turk në një njoftim të publikuar në X.

Ai tha se është e rëndësishme të hapen më shumë hapësira për diplomaci në rajon dhe se regjimi sirian duhet të angazhohet në procesin e zgjidhjes politike.

Erdogani është zotuar se Turqia do ta mbajë qëndrimin e saj sa i përket luftës kundër Partisë së Punëtorëve të

Kurdistanit (PPK), që është shpallur organizatë terroriste nga Turqia dhe Shtetet e Bashkuara dhe "zgatimeve" të saj që po tentojnë të përfitojnë nga zhvillimet e fundit në Siri, u tha në njoftim.

Erdogani dhe Putini zhvilluan këtë bisedë telefonike në kohën kur rebelët sirianë po avancojnë kundër forcave qeveritare, pasi morën nën kontroll Alepon javën e kaluar. Më 3 dhjetor rebelët i janë afruar qytetit Hama, thanë rebelët dhe Vëzhguesi sirian për të Drejtat e Njeriut.



## ShSKUK-ja dhe Fakulteti i Mjekësisë nisin hapat për bashkëpunim

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Anëtarët e Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe drejtori i përgjithshëm, Elvir Azizi, kanë pritur në takim pune dekanin e Fakultetit të Mjekësisë, Sefedin Muçaj, i cili shoqërohej nga

prodekanët dhe bashkëpunëtorët. Në fokus të takimit ishte formimi i grupit punues ndërmjet ShSKUK-së dhe Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, i cili grup do t'i vendosë linjat e bashkëpunimit dypalësh. Dren Boshnjaku, kryesues i

Bordit Drejtues në ShSKUK, tha se me qëllim që bashkëpunimi dypalësh të jetësohet, e që është edhe obligim ligjor dhe statutor, është vendosur të krijohet një grup i përbashkët punues i cili do t'i vendosë linjat e bashkëpunimit. Elvir Azizi, drejtor i

përgjithshëm i ShSKUK-së, e mbështeti formimin e grupit punues në mënyrë që bashkëpunimi të jetësohet edhe praktikisht e që do të jetë në të mirë të dy palëve. Dekani i Fakultetit të Mjekësisë, Sefedin Muçaj, theksoi se bashkëpunimi dhe formimi i grupit punues



do ta ndihmojë dhe forcojë pjesën arsimore, atë shëndetësore dhe kërkimore-shkencore.

## Djali i Jakup Krasniqit i bashkohet PDK-së, garon për deputet në zgjedhjet e 9 shkurtit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka mirëpritur të mërkurën në parti djalin e Jakup Krasniqit, Altin, i cili do të jetë edhe kandidat për deputet në listën e PDK-së në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Krasniqi është shprehur i lumtur që PDK-së po i bashkohet një zë i ri, por që është i rrënjësor thellë në trashëgiminë e shërbimit, sakrificës dhe përkushtimit të palëkundur ndaj vendit. Altin Krasniqi nuk është thjesht djali i një personaliteti të jashtëzakonshëm si Jakup Krasniqi,

përkushtimi i të cilit për Kosovën mbeti i palëkundur si në luftë ashtu edhe në paqe. "Altini përfaqëson premtimin e një gjenerate të re, të gatshme për t'i çuar përpara vlerat tona të përbashkëta. Me energjinë, vizionin dhe përkushtimin e tij, Altini po i hyn politikës për ta nderuar trashëgiminë e babait të tij dhe për të ndihmuar në ndërtimin e një Kosove më të zhvilluar dhe më të mirë. Altin, mirë se erdhe në PDK. Me ty si deputet, Kosova mundet ma mirë!", ka thënë kreu i PDK-së.

Ndërkaq Altin Krasniqi është shprehur se duke qenë djali i një personaliteti si Jakup Krasniqi që ia kushtoi jetën lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, ka vendosur të marrë

përgjegjësi për të punuar për të ardhmen e Kosovës. "I frymëzuar nga trashëgimia e babit, kam vendosur edhe unë të bëj hapin tim dhe t'i bashkojem Partisë Demokratike të Kosovës si kandidat për deputet. Ka ardhur koha që gjenerata jonë të marrë përgjegjësi, që duke nderuar sakrificat e së kaluarës, të punojmë shumë për ndërtimin e një të ardhme më të mirë për të gjithë, pa dallim. Unë besoj se Kosova ka më shumë potencial sesa kaq dhe padyshim që mundet ma mirë. Unë jam Altin Krasniqi dhe jam gati të shërbej, ashtu siç ka bërë babai gjithmonë: me nder dhe përgjegjësi!", ka thënë Altin Krasniqi.



## Mbi 10 mijë studentë dhe staf akademik kanë përfituar nga programi Erasmus +

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Nga viti 2015 deri në vitin 2024 më shumë se 10 000 studentë dhe staf akademik kanë përfituar nga programi Erasmus +.

Zëvendësministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arsim Ademi dhe shefi për Bashkëpunim në Zyrën e BE-së, Johannes Madsen, kanë paraqitur rezultatet e projekteve të Erasmus+ për ndërtimin e kapaciteteve në arsimin e lartë.

Zëvendësministri i Arsimit, Arsim Ademi, tha se është punuar shumë



për promovimin e arsimit profesional. "Në fushën e arsimit profesional këtë vit është arritur

bashkëpunim i suksesshëm deri më tani. Agjencitë përfituese nga Kosova janë Agjencia e Arsimit dhe

Aftësimi Profesional, MASHTI, dy universitete publike dhe dy kolegje, si dhe Oda e Hotelierisë dhe e Turizmit. Në këtë fushë kemi punuar shumë për promovimin e arsimit profesional", tha ai.

Ndërsa shefi për Bashkëpunim në Zyrën e BE-së, Johannes Madsen, tha se nga viti 2015 deri në vitin 2024 më shumë se 10 000 studentë dhe staf akademik kanë përfituar nga ky projekt. "Nga viti 2015 deri në vitin 2024 më shumë se 10 000 studentë dhe staf akademik kanë përfituar nga aksioni i Lëvizshmërisë Ndërkombëtare të Kredive. Ky moment historik pasqyron integrimin në rritje të Kosovës në

komunitetin akademik evropian. Përveç kësaj, ndërmjet viteve 2016 dhe 2024, 63 studentë nga Kosova kanë marrë bursa të përbashkëta për diplomën master Erasmus+, një arritje që nxjerr në pah përsosmërinë dhe ambicien e rinisë së Kosovës. Institucionet e arsimit të lartë të vendit gjithashtu kanë lulëzuar, duke përfituar nga 76 projekte të Ngritjes së Kapaciteteve në Arsimin e Lartë, tetë projekte Jean Monnet dhe dy masat e dizajnit Erasmus+. Këto nisja janë jetike jo vetëm për zhvillimin institucional, por edhe për nxitjen e reformave transformuese në sektorin e arsimit", u shpreh Madsen.

## Haxhiu thekson rëndësinë e bashkëpunimit institucional për luftimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, të mërkurën, në një tryezë me temën "Lufta kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave: praktikë dhe avokimi - zbatimi dhe rruga përpara", diskutoi mbi hartimin e politikave për parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj grave nga Ministria e Drejtësisë. Ajo tha se në këto tri vitet e fundit ka pasur veprime, debate dhe diskutime si asnjëherë më

parë mbi dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore meqë kjo ka qenë edhe prioritet i Qeverisë së Kosovës. Ndër të tjera, ministria Haxhiu tha se në kuadër të aktiviteteve të Fushatës "16 Ditët Kundër Dhunës me Bazë Gjinore", do të lansohen edhe tri akte nënligjore, ku në njërin prej tyre do të konsolidohet roli i Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës.

Po ashtu, do të bëhet lansimi i

linjës telefonike falas dhe funksionalizimi i mekanizmave lokale që merren me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Ministria Haxhiu theksoi rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe shoqëror për luftimin e dhunës, ndërsa adresoi hendekun midis ligjit dhe praktikës ku kërkoi që çdo viktimitë të trajtohet me dinjitet dhe respekt, dhe që çdo rast dhunë të hetohet dhe ndiqet deri në fund.





## Osmani dhe Kurti në Bruksel e shtrojnë si temë sulmin e fundit në veri

Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti gjatë takimit që patën ndaras me presidentin e Këshillit Evropian, Antonio Costa, kanë diskutuar edhe për zhvillimet në fushën e sigurisë, përfshirë sulmin e fundit terrorist në infrastrukturën vitale të Kosovës në kanal in e Ibër-Lepencit, sulm ky që kishte për qëllim që të linte një pjesë të madhe të qytetarëve të Kosovës pa ujë, pa energji elektrike, pa ngrohje dhe me pengesa në sistemin e telekomunikimit. Dy zyrtarët shtetërorë të Kosovës kanë shprehur gatishmërinë e plotë të institucioneve të vendit për bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë për hetimin e aktit terrorist kundër infrastrukturës vitale në Kosovë

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**BRUKSEL, 4 DHJETOR** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti, në prag të Samitit BE - Ballkani Perëndimor në Bruksel, janë prituri në takim nga presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa. Në këtë takim presidentja Osmani e ka uruar atë për detyrën e re, duke shpresuar në vazhdimin e bashkëpunimit në interes të përbashkët.

Presidentja Osmani diskutoi për zhvillimet në fushën e sigurisë, përfshirë sulmin e fundit terrorist në infrastrukturën vitale të Kosovës, sulm ky që kishte për qëllim të linte një pjesë të madhe të qytetarëve të Kosovës pa ujë, pa energji elektrike, pa ngrohje dhe me pengesa në sistemin e telekomunikimit.

Ajo paraqiti para presidentit Costa dëshmitë për lidhjet e Serbisë me këtë sulm, si dhe me sulmin e shtatorit të vitit të

kaluar, i cili ishte akt agresioni ndaj Kosovës. Ajo shtoi se kryeterroristi që kishte zbatuar urdhrat e Beogradit zyrtar për sulme ndaj Kosovës, pra Radojçiç, ende është i lirë dhe kjo dëshmon mungesën e gatishmërisë së Serbisë për përgjegjësi dhe llogaridhënie për aktet e agresionit ndaj Kosovës.

Presidentja Osmani ka shprehur gatishmërinë e plotë të Kosovës për bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar për hetimin e aktit terrorist kundër infrastrukturës vitale në Kosovë, gjersa i ka falënderuar BE-në, ShBA-në si dhe shtetet e tjera të NATO-s, dhe përtej për solidaritetin e treguar dhe ndihmën e ofruar. Ajo potencoi se është shumë me rëndësi që, përveç hetimit, puna jonë e përbashkët të fokusohet edhe në parandalimin e sulmeve të reja.

Presidentja theksoi se në mënyrë që të garantohet stabilitet në Ballkanin

Perëndimor është më rëndësi të jemi unikë në luftimin e kërcënimeve që rrezikojnë paqen dhe sigurinë e Kosovës dhe gjithë rajonit. Ajo shtoi se Kosova është e përkushtuar për përmbyshjen e objektivave të saj të integritimit evropian, ndaj kërkoi mbështetje për avancimin e aplikimit të Kosovës për statusin e vendit kandidat në BE. Për më tepër, presidentja nënvizoi se heqja e masave kufizuese do të ishte një mesazh i fuqishëm për Kosovën për të kontribuar në vlerat dhe vizionin e përbashkët të Bashkimit Evropian, duke argumentuar sërish se ato janë të padrejta dhe se e dëmtojnë më së shumti popullin e Kosovës, por edhe vetë parimin e balancës dhe paanshmërisë në dialogun Kosovë - Serbi.

Ndërkaq kryeministri Kurti tha se pati kënaqësinë ta takojë dhe të bashkëbisedojë me presidentin e ri të Këshillit Evropian, Antonio Costa. Kurti

e uroi ish-kryeministrin e Portugalisë për rolin e ri dhe angazhimin tashmë si president i Këshillit Evropian, duke shprehur edhe gatishmërinë për bashkëpunim të ngushtë. Gjithashtu, e falënderoi për mikpritjen dhe për darkën e organizuar për liderët e Ballkanit Perëndimor.

Përgjatë bisedës së zhvilluar mes tyre, u trajtuan një sërë çështjesh, kryesisht me fokus në rrugëtimin e Kosovës drejt integritimit evropian.

Kryeministri Kurti theksoi se Kosova ka njohur veçanërisht në katër vitet e fundit rritje ekonomike dhe progres demokratik, të dëshmuar edhe nga matjet ndërkombëtare dhe rankimet e larta të organizatave si World Justice Project, Freedom House, Transparency International, Instituti V-Dem, apo edhe FMN-ja dhe Banka Botërore.

Ai shtoi se edhe Raporti për Vëditin 2024 e etabloi Kosovën si një nga performuesit më të mirë të rajonit. Në kuadër edhe të Planit të Rritjes, ai tha se Kosova dëshmoi përgatitjen e saj institucionale, gjersa në zbatimin e agjendës së reformave ERA II u arrit një shkallë zbatimi prej 72 % nga 45 % sa ka qenë në qeverisjet e kaluara, ndërsa në Programin Kombëtar për Integritim Evropian (PKIE) niveli i zbatimit në vitin 2023 arriti në 66.12 %.

Së bashku edhe me përafrimin

e standardeve me ato të Bashkimit Evropian si dhe linjëzimin me politikat e BE-së, kryeministri Kurti nënvizoi se të gjithë faktorët janë tregues të zhvillimit e progresit të vendit dhe gatishmërisë për hapa të rëndësishëm në rrugën drejt BE-së, në një proces të bazuar në meritokraci. Kësisoj, ai rikujtoi rëndësinë e ofrimit sa më shpejt të pyetësorit dhe vendit kandidat si rezultat, pasi Kosova është demokracia më e zhvilluar e rajonit.

Kryeministri Kurti theksoi nevojën për heqjen sa më parë të masave ndëshkuese ndaj Republikës së Kosovës. Më tej, kryeministri foli edhe rreth situatës së sigurisë dhe sulmeve të fundit.

Ai e informoi presidentin Costa mbi sulmin kinetik terrorist të së premtës së 29 nëntorit në kanal in e Ibër-Lepencit, dhe qëllimin e këtij sulmi për ta dëmtuar prodhimin e energjisë elektrike dhe furnizimin e ujit, nga i cili më shumë se gjysma e popullsisë do të mbetej pa energji elektrike dhe ujë. Ai theksoi rëndësinë e arrestimit dhe ekstradimit të kryekriminelit dhe kryeterroristit Millan Radojçiç, për të cilin Prokuroria tashmë ka një aktakuzë prej 160 faqesh për të dhe grupin e tij, dhe i cili vazhdon të paraqesë rrezik për sigurinë e vendit dhe të rajonit për sa kohë që endet i lirë në Serbi dhe ka mbështetjen e presidentit Aleksandar Vuçiq dhe aparatit shtetëror atje.

## O'Brieni njoftohet me situatën e fundit në Kosovë

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti ka takuar në ndërtesën e Ambasadës së Kosovës në Belgjikë ndihmëssekretarin amerikan të Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien.

Temë e diskutimit ishin marrëdhëniet dypalëshe dhe zhvillimet aktuale me interes të përbashkët, me theks te sulmi terrorist i 29 nëntorit ndaj infrastrukturës kritike të Republikës së Kosovës.

Kryeministri ndau me O'Brien hollësitë e sulmit të fundit terrorist mbi infrastrukturën kritike, përkatësisht në kanalën e Ibër-Lepencit si dhe reagimin e institucioneve shtetërore për sanimin e dëmit dhe sigurimin e furnizimit me shërbime esenciale.

Sulmi i 29 nëntorit ishte sulm mbi popullsinë civile meqë përmes tij u rrezikua që më shumë se gjysma e popullatës së vendit të mbetet pa energji elektrike dhe pa ujë, u shpreh kryeministri.

Ndërkohë që hetimet për sulmin e fundit po vazhdojnë, kryeministri nënvizoi që në mesin e konfiskimeve të bëra në lidhje me rastin, krahas armatimit dhe municioneve, janë gjetur edhe 74 emblema ushtarake, prej të cilave 20 janë të njëjësive të ndryshme ushtarake ruse, përveç atyre



serbe.

Sulmi i së premtes së 29 nëntorit ishte sulmi i tretë në tri ditë që për cak kishte institucionet e vendit. Paraprakisht target ishin Stacioni i Policisë në Zveçan dhe ndërtesa e Kuvendit të Komunës së Zveçanit. Gjithashtu, ai përbën sulmin e dytë në shkallë të madhe ndaj sigurisë kombëtare, pas sulmit

paramilitar më 24 shtator 2023 në Banjskë, që për qëllim kishte aneksimin e veriut të vendit dhe ku mbeti i vrarë një rreshter i Policisë së Kosovës, dhe sulmin më të madh dhe më serioz ndaj infrastrukturës kritike, që për qëllim kishte ndërprerjen apo vështirësimin e shërbimeve esenciale, si rryma, uji dhe telekomunikimi, dhe

çrregullimin e jetës shoqërore, qytetare, ekonomike dhe të institucioneve.

Gjatë këtij takimi kryeministri theksoi rëndësinë e arrestimit dhe ekstradimit të kryekriminalit dhe kryeterroristit Millan Radoičiq, për të cilin Prokuroria tashmë ka një aktakuzë prej 160 faqesh për të dhe grupin e tij, dhe i cili vazhdon të paraqesë rrezik për

sigurinë e vendit dhe të rajonit për sa kohë që endet i lirë në Serbi dhe ka mbështetjen e presidentit Aleksandar Vuçiq dhe aparatit shtetëror atje.

Kryeministri Kurti falënderoi ndihmëssekretarin amerikan O'Brien dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e tyre ndaj Republikës së Kosovës në hetimin e sulmit në kanalën e Ibër-Lepencit dhe sjelljes së përgjegjësve para drejtësisë.

Edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka zhvilluar një bisedë me ndihmëssekretarin amerikan të Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, lidhur me sulmin e 29 nëntorit ndaj kanalit të ujit të Ibër-Lepencit në Zubin Potok.

Këshilltari politik i Osmanit, Bekim Kupina, tha për Radion Evropa e Lirë se Osmani, përveç me O'Brien, ka zhvilluar biseda edhe me udhëheqës të tjerë ndërkombëtarë, përfshirë edhe me sekretarin e Jashtëm britanik, David Lammy.

"Ajo [Osmani] i ka falënderuar për reagimin dhe dënimin e sulmit ndaj infrastrukturës vitale në Ibër-Lepenc. Diskutimet u fokusuan në sulmin e fundit terrorist ndaj infrastrukturës vitale të Kosovës dhe implikimet e tij për stabilitetin e Kosovës dhe më gjerë", tha Kupina.

## PDK-ja në Prishtinë: Përparim Rama po synon ta falimentojë 'Pastrimi'-n dhe t'i lë 900 punëtorë pa punë

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Partia Demokratike në Prishtinë në një konferencë për medie alarmoi për situatën e krijuar të menaxhimit të mbeturinave në kryeqytet, e cila po bëhet e papërbalueshme dhe e rrezikshme për qytetarët e Prishtinës.

Asambletja e PDK-së në Kuvendin Komunal të Prishtinës, Gresa Lahu, ka theksuar të mërkurën se, përveç mungesës së shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave, mungesë ka edhe te mekanizmat veprues, siç janë kamionët dhe kontejnerët. Ajo ka thënë se udhëheqësit komunalë në krye me Përparim Ramën dhe drejtorin e DShP-së, Bekim Brestovcin, kanë tendencë të shtyjnë përpara vendime që jo vetëm e dëmtojnë xhepin e qytetarëve dhe buxhetin e komunës, por në mënyrë direkte dhe të pakthyeshme i dëmtojnë edhe rreth 900 punëtorë të ndërmarrjes publike, duke i lënë ata të pa punë dhe duke e falimentuar ndërmarrjen "Pastrimi", që do të krijonte krizë socio-ekonomike në rreth 900 familje.



Ndërsa Granit Geci, asambleti tjetër i PDK-së në Kuvendin Komunal të Prishtinës, ka shprehur shqetësimin e tij për mungesën e vullnetit dhe

mbështetjen e komunës së Prishtinës ndaj ndërmarrjes publike e cila operon në kushte të vështira, gjendje kjo e krijuar qëllimshëm nga komuna e

Prishtinës, që t'ia japë më lehtë tenderin prej 16.5 milionë eurosh operatorit privat në këtë veprimtari publike. Kjo gjendje për menaxhimin e

mbeturinave në Prishtinë, sipas tij, është e qëllimshme që të favorizohet operatori privat, duke mos e harruar as faktin që komuna e Prishtinës tash e tri vjet nuk e ka blerë as edhe një kamion të vetëm për ndërmarrjen publike dhe po i ruan kontejnerët e rinj për t'ia ofruar operatorit privat.

Asambletët e PDK-së në Kuvendin Komunal të Prishtinës do ta ushtrojnë të drejtën e tyre në Plotësim/ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave dhe i kanë ftuar të gjithë asambletët e tjerë ta mbështesin rregulloren, e cila ka për qëllim përmirësimin e situatës me mbeturinat në kryeqytet.

Ata i kanë bërë thirrje edhe kryetarit Përparim Rama që urgjentisht ta bëjë shpërndarjen e kontejnerëve, të investojë në kamionë të rinj dhe ta anulojë tenderin 16 milionësh, i cili rrezikon grantin e KFW-së në vlerë mbi 70 milionë euro, marrëveshje kjo që do të garantojë një zgjidhje afatgjatë për përmirësimin e gjendjes në kryeqytet.

## MASHTI hap konkurs për mësimdhënësit që duan ta marrin Licencën e Avancuar për Mësimdhënie

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka hapur konkurs për mësimdhënësit që dëshirojnë ta marrin Licencën e Avancuar për Mësimdhënie.

Në "Facebook", ministrja e këtij dikasteri, Arbërie Nagavci, ka deklaruar se ky është hap i rëndësishëm drejt avancimit të

performancës së mësimdhënësve. "Hap i rëndësishëm drejt avancimit të performancës së mësimdhënësve. Në kuadër të reformave për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe avancimit të performancës së tyre kemi hapur sot thirrjen për aplikim për mësimdhënësit që synojnë të

marrin Licencën e Avancuar për Mësimdhënie. Kjo është thirrja e parë publike që MASHTI e bën për mësimdhënësit e shkollave publike në Kosovë. Thirrja vlen për mësimdhënësit e profileve si më poshtë: 1. Mësues të arsimit fillor; 2. Mësimdhënës të lëndës 'Matematikë' në Arsimin e Mesëm të Ulët

(AMU) dhe Arsimin e Mesëm të Lartë (AML); 3. Mësimdhënës të lëndës 'Gjuhë shqipe' në Arsimin e Mesëm të Ulët (AMU) dhe Arsimin e Mesëm të Lartë (AML)", ka shkruar Nagavci.

Aplikimi mund të bëhet përmes platformës e-kosova nga 4 deri më 19 dhjetor. Të gjitha ato/ata që do ta



përmbyllin suksesshëm këtë proces do ta përfitojnë shtesën e performancës.

## 'K'cimi i Tropojës' mbrohet nga UNESCO

PRISHTINË, 4 DHJETOR - "K'cimi i Tropojës", një vallëzim i njohur festiv shqiptar, është futur edhe zyrtarisht në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë, UNESCO, njoftoi të mërkurën ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit i Shqipërisë, Blendi Gonxhja.

"Pas vlerësimit pozitiv nga Organizmi i Vlerësimit të UNESCO-s, gjatë sesionit 19 të Komitetit Ndërqeveritar për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, në Asuncion, Paraguai, 'K'cimi i Tropojës' është tashmë pjesë e Listës Përfaqësuese të



Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit", tha Gonxhja.

Ai e ka vlerësuar vendimin e UNESCO-s hap të radhës drejt "lartësimit të vlerave kombëtare duke na bërë edhe

më krenarë për vendin tonë". "K'cimi i Tropojës" është një vallëzim festiv që praktikohet gjatë gjithë vitit, veçanërisht gjatë ceremonive festive tradicionale si, dasma, fejesa, ditëlindje, ceremoni inicimi,

festa fshati dhe raste të tjera shoqërore, përfshirë ato që janë më pak zyrtare, shpesh mjaft spontane.

Vallja ka lëvizje ritmike dhe shoqërohet me tupan, çifteli dhe fyell, ndërsa valltarët mbajnë veshje tradicionale dhe shami të kuqe ose të verdhë.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, thotë se me këtë vendim "rilindi një trashëgimi që po braktisej dhe harrohej". Dosja për "K'cimin e Tropojës" u dorëzua në UNESCO tre vjet më parë bashkë me "Transhumancën" dhe "Xhubletën", të cilat janë marrë në mbrojtje nga UNESCO.

"K'cimi i Tropojës" është shpallur më herët nga

Ministria e Kulturës dhe Akademia e Shkencave në Shqipëri pjesë e listës së kryeveprave të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale.

Xhubleta shqiptare, veshja katër mijëvjeçare, është marrë në mbrojtje nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë dy vjet më parë. Ky vendim do të ndihmojë për ta ruajtur mjeshtërinë e krijimit të saj brez pas brezi.

Ndërsa tradita e shtegtimin të bagëtive apo "Transhumanca" u mor në mbrojtje nga UNESCO një vit më parë.

Pjesë e listës së pasurive botërore që mbrohen nga UNESCO janë edhe Butrinti, Berati, Gjirokastra si dhe isopolifonia.

## Në veri sërish gjenden armë dhe uniforma ushtarake

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, tha se gjatë një bastisjeje të kryer në pjesën veriore të Kosovës më 3 dhjetor janë gjetur armë, municione dhe pajisje të tjera ushtarake. Ai ka publikuar një video të armëve që janë sekuestruar, që tha se ishin fshehur në një ahur, duke mos bërë të ditur se në cilin vend u kryen bastisjet. "Përveç uniformave të ushtrive të Serbisë dhe Rusisë, në këto dëshmi shihen uniforma të ushtrive të Shteteve të Bashkuara dhe asaj britanike dhe ky fakt shpërfaq planet dhe skenarët ogurzi për të kryer krime dhe sulme dhe për të fajësuar shtete të tjera", shkroi ai në "Facebook".

Që nga sulmi me mjete plasëse

në kanal in e ujit të Ibër-Lepencit në Zubin Potok më 29 nëntor, autoritetet e Kosovës po kryejnë bastisje në pjesën veriore të shtetit të banuar me shumicë serbe. Gjatë bastisjeve Policia e Kosovës ka njoftuar se ka sekuestruar lloje të ndryshme armësh, pajisjesh ushtarake dhe uniforma.

Po ashtu, nga dhjetë të shoqëruarit në Polici, si të dyshuar për përfshirje për shpërthimin në Ibër-Lepenc, dy nga ta janë dërguar në parburgim për një muaj.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha më herët gjatë 3 dhjetorit se në bastisjet e kryera në veri kanë gjetur, ato që ai i cilësoi si "elemente ruse". "Ka armatim të konfiskuar dhe materiale që janë gjetur. Nga 74 emblema që



u konfiskuan, 20 prej tyre janë ruse, prej njësive të ndryshme ruse, të tjerat janë kryesisht serbe. Është edhe një e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që na bën të mendojmë se dikush ka dashur që hetimet e ardhshme të shkojnë në drejtim të gabuar, apo siç thuhet në fjalorin e NATO-s,

"false flag operation", tha Kurti gjatë një prononcimi për medie në Bruksel, ku ka zhvilluar takime me zyrtarët e rinj të Komisionit Evropian.

Kosova ka fajësuar Serbinë për shpërthimin në Zubin Potok, por Beogradi ka mohuar përfshirjen në sulmin të cilin e ka dënuar dhe ka thënë se do ta

hetojë.

Shpërthimi ndodhi më 29 nëntor në fshatin Varragë të komunës së Zubin Potokut - komunë me shumicë serbe në veri të vendit.

Policia e Kosovës ka thënë se sulmi është kryer me lëndë shpërthyesë deri në 20 kilogramë. Sulmi në Zubin Potok është dënuar ashpër nga faktori ndërkombëtar.

Kanali Ibër-Lepenc furnizon me ujë nga Liqeni i Ujmanit gjithë veriun e Kosovës, rajonet e Mitrovicës, Prishtinën me rrethinë, si dhe Korporatën Energjetike të Kosovës për ftohjen e termoelektraneve të saj. Para shpërthimit në kanal in e ujit, në veri të Kosovës ishin regjistruar edhe dy incidente me mjete shpërthyesë.

## Kosova dhe Mbretëria e Arabisë Saudite nënshkruajnë marrëveshje doganore

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar se ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi doganor me ministrin e Financave të Arabisë Saudite, Mohammed Al Jadaan. "Marrëveshjen e nënshkruam në ceremoninë hapëse të Konferencës Ndërkombëtare për Zekatin, Tatimin dhe Doganat 2024, ku po marrim pjesë bashkë me drejtorin e

Doganave z. Agron Llugaliu dhe atasheun doganor z. Bekim Mehmetaj", ka shkruar Murati në "Facebook".

Ai ka theksuar se kjo marrëveshje, që adreson çështjet doganore dhe është në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, përfaqëson një hap të madh përpara në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona. "Duke përfunduar

bashkëpunimin tonë shumëdimensional në fushën e doganave, marrëveshja do të kontribuojë në lehtësimin e tregtisë, përmirësimin e sigurisë dhe rritjen e bashkëpunimit ekonomik. "Republika e Kosovës vazhdon të ndërtojë partneritete që sjellin përfitime të prekshme për ekonominë dhe qytetarët tanë, njëkohësisht forcojnë lidhjet tona me shtetet mike", ka thënë Murati.



# Kushtet e punës te sektori privat, problematike mbesin pushimet vjetore dhe ai i lehonisë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 4 DHJETOR** - Organizata "Çohu" në një tryezë ka paraqitur dy hulumtime që kanë të bëjnë me kushtet e punës të punëtorëve të sektorit privat. Hulumtimet janë fokusuar në dy tema: kontratat e punës dhe obligimet që dalin nga këto kontrata siç janë pushimet. Për të dy hulumtimet janë realizuar dy pyetësorë të cilëve u janë përgjigjur mbi 270 responentë ku janë marrë opinionet e qytetarëve për kushtet e tyre të punës dhe marrëdhënien punëdhënës-punëmarrës. Sipas përgjigjeve të qytetarëve, pajisja e punëtorëve me kontrata të punës është rritur, por sfida mbetet respektimi i saj. Më shumë se 20 për qind të responentëve që i janë përgjigjur pyetësorit kanë thënë se kanë një vend pune, por nuk kanë kontratë pune.

Se a respektohet kontrata e punës nga punëdhënësit, 54.90 për qind kanë thënë që po, ndërsa 45 për qind kanë thënë jo. Kontrata e punës nuk respektohet më së shumti te pushimet. Shumica e responentëve mendojnë se në Kosovë nuk u respektohen pushimet punëtorëve që punojnë në sektorin privat. 33.66 për qind prej tyre kanë thënë se pushimet nuk u respektohen aspak punëtorëve, pak kanë thënë 29.21 për qind, 20.30 për qind kanë thënë mesatarisht, ndërsa shumë vetëm 16.83 për qind. Sipas këtij hulumtimi, problematike në zbatim mbesin pushimet vjetore dhe të lehonisë. Sa i përket pushimit vjetor, 22.28 për qind e responentëve që i janë përgjigjur pyetësorit kanë thënë se atyre nuk u është dhënë kurrë pushimi vjetor, 44.55 për qind e tyre kanë thënë se u është dhënë nganjëherë dhe 33.17 për qind janë përgjigjur se ky pushim u



është dhënë gjithnjë. Sa i përket faktit se a janë paguar pas shfrytëzimit të pushimit vjetor, 80 për qind prej tyre kanë thënë po dhe 20 për qind jo. Te pushimi i lehonisë statistikisht tregojnë që ky pushim deri diku u respektohet punëtorëve nga punëdhënësit. 49.44 për qind e responentëve në pyetësorin e Preportr kanë thënë se nuk u është dhënë ky pushim, ndërsa 50.66 për qind që u është dhënë. Preportr i ka pyetur responentët

se në rast që u është dhënë pushimi, a u është kompensuar ashtu siç parashihet me ligj. Më shumë se 73 për qind kanë thënë se u kompensohet, 26.67 për qind kanë thënë se jo. Nëse nuk janë kompensuar nga punëdhënësit, responentët kanë thënë se nuk janë ankuar në asnjë institucion. Edhe kur u është mohuar ky pushim shumë pak prej tyre janë ankuar në ndonjë institucion. Vetëm 4.55 për qind e tyre kanë thënë se janë ankuar, ndërsa

95.45 për qind se nuk janë ankuar. Edhe në rastet kur janë marrë vendimet nga institucionet në favor të punëtorëve, ato nuk janë respektuar nga punëdhënësit. Në tryezën e mbajtur në të cilën u paraqitën këto të dhëna, kanë marrë pjesë Johan Schmidt, udhëheqësi i ekpiti për Evropë i Olaf Palme International Centre, Vesel Zhinipotoku nga Inspektorati i Punës dhe disa organizata të shoqërisë civile. Schmidt, ndër të tjera, tha se do të duhej që dialogun social ta kuptojmë në një formë më gjithëpërfshirëse, ku mbrojtja e të drejtave të punëtorëve nuk shkon vetëm në interes të tyre, por është thelbësore edhe për funksionimin dhe zhvillimin e bizneseve. Në tryezë u diskutua për domosdoshmërinë e plotësim-ndryshimit të Ligjit të Punës, rritjen e numrit të inspektiveve dhe përfshirjen e aktorëve relevantë në dialogun social.

## SBASHK-u proteston për rritje pagash dhe kontratën kolektive

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 4 DHJETOR** - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) ka mbajtur një protestë të mërkurën në Prishtinë, në të cilën ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës zbatimin e një kontrate kolektive si dhe rritje pagash për mësimdhënësit. Protestuesit marshuan nga Biblioteka Kombëtare drejt ndërtesës së Ministrisë së Arsimit e deri te ndërtesa e qeverisë, duke bërë thirrje për përmirësimin e kushteve të mësimdhënësve. Nga aty, kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, hodhi kritika në adresë të qeverisë Kurti. "Ministrja Nagavci as edhe një herë nuk u bë zë i të punësuarve në arsim dhe as edhe një herë nuk foli në qeveri e nuk kërkoi të debatohej për

kërkesat legjitime të punëtorëve të arsimit. Ajo u mundua ta mohojë e zhvleftësojë njëanshëm Kontratën Kolektive të Arsimit dhe atëherë deklaronte se do të bisedohet për kontratën e re, por shihet se e ka pasur vetëm si deklaratë, sepse tani e sa muaj i kemi drejtuar kërkesa për dialog lidhur me kontratën dhe më 2 tetor ia kemi dorëzuar draftin e ri të Kontratës Kolektive të Arsimit. Por, ajo nuk do dialog e as negociim dhe mos të harrojë ministrja Nagavci se duke qenë kundër Kontratës së re Kolektive të Arsimit është kundër punëtorëve të arsimit, sepse Kontrata Kolektive është bazament që siguron dhe garanton të drejtat legjitime të punëtorëve arsimorë dhe nuk lejon që dikush t'i shkelë ato", u shpreh Jasharaj. Varësisht nga niveli arsimor ku punojnë dhe nga përvoja e punës,

mësimdhënësit do të paguhen nga 671 euro deri në 737 euro, pas vendimit të qeverisë për rritje të pagave në sektorin publik nga janari 2025. Nga viti 2014 janë nënshkruar tri kontrata kolektive ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sindikatës së Arsimit, por ato nuk janë zbatuar kurrë plotësisht. Kontrata e fundit kolektive, e nënshkruar në vitin 2021, është ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga Ministria e Arsimit në nëntor të vitit të vitit 2022, me arsyetimin se nuk është menaxhuar siç duhet.

### PSD-ja mbështet SBASHK-un në kërkesa

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se partia e tij mbështet kërkesat e SBASHK-ut. "Mbështesim SBASHK-un në kërkesa dhe manifestimin e saj



përmes protestës. Partia Socialdemokrate e sheh jetike Kontratën Kolektive dhe avancimin e kushteve të punëtorëve të arsimit. Nuk ka alternativë ndaj organizimit sindikal si hapësirë, e rrallë deri më tani, jashtë kontrollit qeveritar. Pushtetet autoritare disiplinonjë e kontrollojnë,

mirëpo kjo bëhet e dallueshme, del në pah, vetëm falë organizimit dhe rezistencës. Janë forcat kundër autoritarizmit ato që dëshmojnë natyrën e pushtetit si të tillë. Në solidaritet me punëtorët e arsimit", ka shkruar në "Facebook" kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj.

## Kthehen shkurtimet e ujit në tri komuna

**MITROVICË, 4 DHJETOR** - Kompania e ujësjellësit e rajonit të Mitrovicës, KRU Mitrovica, njoftoi të mërkurën se do të zbatojë shkurtime në furnizimin me ujë për konsumatorët e saj në Mitrovicën e Jugut, Vushtrri dhe Skenderaj si rezultat i pasojave që shkaktuan dëmet nga sulmi në kanal in e ujit të Ibër-Lepencit javën e kaluar. Ajo tha se banorët e qytetit të Mitrovicës së Jugut do të përballen me mungesë uji nga ora 18:00 deri në orën 06:00, ndërsa fshatrat e kësaj komune nga ora 09:00 deri në orën 18:00. Banorët e qytetit të Vushtrrisë



nuk do të furnizohen me ujë nga ora 18:00 deri në orën 06:00, ndërsa fshatrat e kësaj komune nga ora 09:00 deri në orën 18:00. Në Skenderaj shkurtimet do të ketë nga ora 18:00 deri në orën

06:00 për banorët e qytetit, ndërsa nga ora 09:00 deri në orën 18:00 për banorët e fshatrave të komunës. Kompania nuk tregoi se sa do të zgjasin shkurtimet e ujit të cilat

vijnë si pasojë e shpërthimit në kanal in e ujit të Ibër-Lepencit në Zubin Potok, për çfarë autoritetet e Kosovës e kanë fajësuar shtetin fqinj - Serbinë. Serbia i ka mohuar akuzat. Kanali Ibër-Lepenc furnizon me ujë nga Liqeni i Ujmanit gjithë veriun e Kosovës, rajonet e Mitrovicës, Prishtinën me rrethinë, si dhe Korporatën Energetike të Kosovës për ftohjen e termoelektraneve të saj. "Me qëllim të furnizimit sa më të mirë për të gjithë konsumatorët tanë, ju lusim që ujin ta konsumoni në mënyrë sa më racionale sidomos në situatën në të cilën ndodhemi",

tha KRU Mitrovica. Ajo u bëri thirrje konsumatorëve të vet të mos e përdorin ujin për pije. KRU Mitrovica funksionon si ndërmarrje publike dhe i furnizon me ujë komunat si Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut pjesërisht, Zveçanin, Vushtrrinë dhe Skenderajn, sipas uebsjtit të kompanisë. Në rrjetin e saj janë të kyçur mbi 100 000 banorë nga këto rajone. Këto tri komuna ishin përballur me shkurtime të ujit menjëherë pas sulmit të 29 nëntorit. Sulmi në Zubin Potok është dënueshëm nga bashkia ndërkombëtare.

# VARRAGA APO VRRAGA E KOSOVËS



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Tymnaja e një dite me diell:** Pas aktit terrorist në kanalën e Ibër Lepencit në Varragë të Zubin Potokut në skenë dolën "ekspertë të sigurisë" që asnjëherë nuk kanë punuar në fushën e sigurisë dhe, në dështimin e parashikimeve ia kalojnë edhe fallxhorëve të ditës së parë kur qesin fall. Nuk mbeti kush pa komentuar këtë akt terrorist, prej KM Kurti e deri te berberët dhe taksistët ku edhe bëhet politika më e lartë. Reagimi i politikanëve kosovarë, sidomos i pushtetit ishte reagim për vota e formës së prerë, ende pa filluar hetimet. Punë të mbarë bënë shërbimet e emergjencës, ndërmarrja e Ibër Lepencit, Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjykatat. Mediat ishin gjithashtu ana e bardhë e një mozaiku bardh e zi ndonëse KM Kurti i portretizoi si më të këqij se vet ata që e kryen këtë sulm terrorist. Në vend që ta thërras një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës ku do të merrej një qëndrim i përbashkët shtetëror dhe institucional për këtë ngjarje, ai u mjaftua me një deklaratë në stilin e Papës së Vatikanit, urbi et orbi nga bazilika e Shën Pjetrit, se ky akt terrorist u organizua nga Serbia dhe Rusia sikur që ky veprim është copy paste i sulmeve ruse në infrastrukturën energjetike vitale të Ukrainës duke menduar se sytë dhe veshët e botës shohin dhe dëgjojnë vetëm Albin Kurtin. Çfarë patologjie e ndjenjës së madhështisë që është shenjë identifikuese dhe vulë e mendimit, veprimt dhe përfundimit politik, filozofik, sociologjik dhe antropologjik të Albin Kurtit, kryeministrit në ikje, mendoj dhe i sigurt pa mundësi riciklimi apo riinkarnimi për postin që e ka, nëse në ndërkohë nuk ndodhin ngjarje që nuk i kanë

paraparë as Nostradamusi dhe Baba Vanga e lëre më vogëlsia ime. Papë Françesku është Baba i besimtarëve katolikë, Albin Kurti është Baba i besimtarëve që e kanë kaluar lavazhin e trurit të lavatritës së Babushkes së VV-së, Dejana Mihali. KM në ikje, Albin Kurti, në vend se të del me një deklaratë me të cilën dyshimet e bazuara i adreson kah Serbia, që do të ishte realiste dhe e pranueshme nga vendimmarrësit kryesorë ndërkombëtarë që kanë fuqi që edhe pecin ta lënë pa k.çe, ai doli me një deklaratë që përmbledhë aktivitetin e policisë, prokurorisë, gjykatës dhe AKI-së që nuk është në përgjegjësi të KM, si menaxheri kryesor politik i qeverisë. Ai tha se Serbia e ka bërë këtë dhe pikë. Shtetet e BE-së, SHBA-ve, Amerikës së Jugut, Afrikës, madje edhe Kina si dhe Orbani e cilësuan këtë si akt terrorist por në asnjë rast nuk e cilësuan Serbinë si kryerës së veprës por, në të njëjtën kohë kërkuan hetime të pavarura dhe të paanshme duke ofruar edhe ndihmë për këto hetime. Të gjithë kërkuan që përgjegjësit për këtë sulm terrorist të sillen para organeve të drejtësisë të cilat do të marrin vendim në bazë të provave e jo në bazë të deklaratave politike. PE kërkoi hetim ndërkombëtar për rastin dhe kjo tregon qartë se nuk iu besojnë hetimeve të institucioneve të Kosovës. A po e djegim rastin e sulmit terrorist në kanalën e Ibër Lepencit sikur që e dogjëm rastin e Banjskës ndonëse i kishim të gjitha provat në anën tonë?! Injoranca profesionale e Kaçketës, bashkë me sekserët e tij që ndërhyjnë në punët e policisë, e dogji Banjskën. Injoranca dhe megalomania politike për përfitime elektorale, lehtësisht mund ta djegin Ibër Lepencin. Politikanët e Kosovës me

impotencë të theksuar politike dhe profesionale po kërkojnë që bashkësia ndërkombëtare të mendojë dhe veprojë si ata dhe kanë mbetur të habitur pse ende nuk po ndërmerren masa kundër Serbisë duke harruar se sanksionet ende janë kundër Kosovës. A janë more këta në tokë të bukës?! Albin Kurti po përpiqet të lë përshtypjen para opinionit se, si sovranist i vetëm në Kosovë po luan në kartën tutti per tutti, të gjitha për të gjitha në mbrojtje të sovranitetit në veri, të cilin realisht, as nuk e ushtron sot, nesër edhe më pak, pasnesër hiç fare. Albini e ka të qartë se lëshimet më të mëdha dhe më të dhimbshme do të duhet t'i bëjë në veri të Kosovës andaj në tavolinë i vendosë koç...t sovraniste të.....Faton Pecit. Vuçiçi na e luajti lojën për Banjskën duke e dërguar në ndalim policor zemlakun e Mimoza Kusarit, Radojiçiqin që nënkupton se me fillimin e procedurës kundër tij, jo që nuk do e ekstradojë Zemlakun e Mimoza në Kosovë por që as vendet tjera, nëse e kapin në territorin e tyre, adresa e parë dhe e vetme e ekstradimit do të jetë Serbia. Me ngritjen eventuale të aktakuzës kundër zemlakut të Mimoza nga ana e Serbisë do të fillojë një proces gjyqësor që do të zgjasë me vite, deri në parashkrimin e rastit apo një lufte tjetër. Një gjë nuk po e kuptoj, a është Serbia një shtet aq naiv që përkundër faktit se gjatë çdo bastisjeje Policia e Kosovës po konfiskon armë të shumta, përsëri po futë brenda armë të tjera! Pak e besueshme ose unë jam më i huçur në parashikime se vet Spartak Ngjela apo Nexh Unmikokosovari.

**Darka e Lamës, garë midis mashtrueses ekzemplare dhe llaskuçit antologjik:** Vojsa Osmani, ish presidentja e Albin Kurtit, tash në rënie të

lirë, kohë më parë organizoi Darkën e Lamës ku të pangopurit për pushtet dhe para mbushnin cullët e tyre me djersën dhe mundin e atyre që memzi mbijetojnë, bujkrobët e Kosovës. Para një jave, një ish jargë e Vojsa Osmani, Faton Peci organizoi edhe një Darkë të Lamës thuaja me të njëjtën përbërje, plus minus disa besnikëve të Vojsa Osmani që, ose nuk erdhën, ose nuk ishin ftuar. Në arenën e gladiatorëve të quajtur Darka e Lamës po bëhet lufta për vdekje apo jetë politike por edhe fizike. Në sofrat e shtruara nga Faton Peci, ushqimi ishte shumë më i kushtueshëm: servohej mish lope me çmim 100.000 euro, flija, pite, bukë dhe gatime të Rozeta Hajdarit dhe Ridit me vlerë disa miliona euro. Nuk ka si të ndodhë ndryshe kur mielli, vaji dhe kripa janë të rezervave shtetërore. Pastaj, edhe vaji është nga rezervat shtetërore sikur që çaji i rusit dhe ëmbëlsirat janë me sheqer të rezervave shtetërore. Vetëm uji ka qenë me çmim të arsyeshëm dhe për këtë u përkujdes shteti pasi ua fali borxhet prodhuesve të ujit. Bukë, krip, zemër dhe .....ujë besoj se do të jetë slogani i VV-së në zgjedhjet e ardhshme. Kjo do të jetë një ofertë e VV-së për zgjedhjet e ardhshme e që nuk do të mund të refuzohet. Si ajo e Don Vito Korleones në filmin Kumbara. Sakrificën më të madhe pas sulmit terrorist e ka bërë Vojsa Osmani duke e shtyrë vizitën një shteti që ka rëndësi jetike për Kosovën, Sulltanatit të Bruneit dhe takimin me Sulltanin Hasan Bolkaiah. Sepse nga kjo vizitë do të dilte diçka, naj copë ari, së paku. Pastaj, Llaskuci i Parë do të kishte rastin të takohet me princ Jaffray, vëlla i Sulltanit. Do t'i këmbenin përvojat nga fusha e mashtrimeve ku janë virtuoz të vërtetë. Princ Jaffray e pasuron

gazi i Bruneit, Llaskucin e Parë fasulja e FSK-së.

**Rezultatet e zgjedhjeve të ardhshme:** Një mik imi i mirë, ish-ushtar i UÇK-së, tash i Albin Kurtit dhe Dejana Babushkes, Kujtim Anarkisti, pas ngjarjes në kanalën e Ibër Lepencit më tha se do të bjerë drastikisht parashikimi im se VV-ja, maksimumin do ta ketë 33 për qind në zgjedhjet e ardhshme. Mendësi euforike dhe folklorike nëse mendohet se Ibri dhe Lepenci do ta lajnë Binin për të gjitha dështimet që i ka bërë gjatë mandatit të plotë 4-vjeçar. Kjo qeveri ngjyrën e bardhë e ka larguar nga përdorimi, shërbëhet vetëm me të zezën, për ta njollësuar opozitën, mediat dhe mendermethënë shoqërinë civile sikur për ta treguar edhe fytyrën e saj qeverisëse. Rasti i Ibër Lepencit, lehtësisht mund që në vend t'ia mbushë xhirrologarinë me vota, mund t'i kthehet si boomerang. VV-ja duhet të jetë e shashtisur nëse i afrohet 30 përqindëshit. LDK-ja dhe PDK-ja rriten, AAK-ja rritet pak, Lista për Familjen e kalon pragun. Do të ketë shpërndarje të madhe të votave dhe koalicionet janë të pashmangshme. Nëse Mimoza Kusari do të ketë shëndet të mirë, do ta forcojë koalicionin ekzistues VV - Lista Serbe. I uroj shëndet të plotë. Kjo është për aq sa shihet, për atë që nuk duket, nuk garantoj. Por, në asnjë mënyrë nuk do të dëshiroj që Kuvendi i ardhshëm të jetë pa kolosët e mendimit politik, filozofik, sociologjik dhe antologjik të eruditëve të shquar, Halil Thaçi, Dimalin, Mefin, Ardianën dhe ushtarët e shquar në luftë për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar, komandantët e UÇK-së, Cen Durmishi, Kaçketa dhe Besnik Gjykeari. Më rrofshin, që të gjithë!



# Çfarë paqe do të kemi pas luftës?



“Lufta në Ukrainë ka trazuar historinë e shekullit njëzet e një, duke u bërë shenjuesja e tij, ashtu si konfliktet e Revolucionit Francez dhe Perandorisë ishin shenjueset e shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe Lufta e Madhe shenjuesja e shekullit të njëzetë”, shkruan Nicolas Baverez në Le Figaro. Ajo mbyllti ciklin e globalizimit. Dhe hapi përplasjen e madhe midis perandorive autoritare dhe demokracive, duke sanksionuar aleancën midis Kinës dhe Rusisë dhe duke e afruar Moskën me Teheranin dhe Phenianin. Ajo hodhi dritë mbi natyrën e tiranive të shekullit njëzet e një, ambicinet e tyre për pushtet dhe përdorimin e pakufizuar të dhunës prej tyre. Ajo e ka reshtuar jugun me autokracitë, siç e pamë në samitin e G20-ës në Rio. Nga ana tjetër, ajo nxorri në pah cenusshmërinë dhe unitetin e demokracive. Prandaj, nuk ka dyshim se rezultati i luftës në Ukrainë do të ketë një rol vendimtar në fatin e lirisë dhe Evropës.

Pas 1000 ditësh luftime, kjo luftë e tmerrshme dhe shkatërruese, e cila vlerësohet të ketë shkaktuar të paktën 700,000 vdekje dhe plagosje nga pala ruse dhe më shumë se 500,000 nga pala ukrainase, ka arritur një pikë kthese të rëndësishme. Pa u dorëzuar, Ukraina ende e gjen veten përballë një situatë shumë të vështirë. Në aspektin ushtarak, ushtria e saj po tërhiqet nga Donbasi, viktimë e mungesës së njerëzve dhe pajisjeve përballë rullit rus, i cili përparon me çmimin e humbjeve të tmerrshme. Përparimi drejt

Kurskut nuk mundësoi që presioni të reduktohej dhe forcat e Kievit janë shumë të ekspozuara përballë 50,000 burrave, përfshirë 12,000 koreano-veriorë, të grumbulluar nga Moska për ta rimarrë.

Në rrafshin politik, popullsia ukrainase, pa u dorëzuar, është e rraskapitur nga bombardimet masive të qyteteve dhe infrastrukturës thelbësore, e cila ka shkatërruar 65 për qind të kapacitetit të prodhimit të energjisë. Në një nivel strategjik, mbështetja e demokracive perëndimore është dobësuar nga zgjedhja e Donald Trumpit, i cili është zotuar t’i japë fund konfliktit brenda 24 orëve – Kiev varet tërësisht nga mbështetja ushtarake dhe financiare e Uashingtonit – si dhe nga ndjekja prej Gjermanisë e një politike qetësimi, me nxitjen e Olaf Scholzit.

Rusia e Vladimir Putinit, nga ana tjetër, ndihet në një pozicion force, e mbështetur nga aleanca me Kinën, e mbështetur nga fluksi i njerëzve, armëve dhe municioneve nga Koreja e Veriut dhe Irani, dhe e legjitimuar nga mbështetja e Jugut, veçanërisht përmes Brics. Në sipërfaqe, është një kohë përshkallëzimi. Nga pala ruse, me vendosjen e një kontingenti të Koresë së Veriut që mund të arrijë 100,000 ushtarë, bombardimet sistematike të qyteteve dhe intensifikimi i operacioneve të destabilizimit dhe dezinformimit në Evropë (Moldavi) dhe Afrikë. Një prag i ri u tejkalua me sulmin në Dnipro përmes një rakete balistike me rreze të mesme veprimi, e krijuar

për të mbajtur koka bërthamore, duke materializuar kërcënimin e përdorimit të armëve atomike përballë një “konflikti global”.

Nga pala ukrainase, me shtrirjen e teatrit të luftës në territorin rus, autorizimin për të goditur objektivat ushtarake në Rusi me raketa perëndimore me rreze të mesme veprimi dhe vendosjen e minave amerikane, për të ndaluar përparimin rus në Donbas.

Megjithatë, prapa përshkallëzimit ushtarak ekziston një moment diplomacie, i përmendur nga Vladimir Putin dhe Volodymyr Zelensky. Konflikti ka arritur në një ngërç, ku asnjëra palë nuk ka arritur të bëjë një hap vendimtar përpara. Rusia ka avantazhin prej shtrirjes dhe popullsisë së saj prej 145 milionë banorësh në krahasim me 37 milionë të Ukrainës, por përpjekja e Vladimir Putinit për të asgjësuar shtetin dhe popullin ukrainas ka dështuar. Të dy vendet janë të rraskapitur. Ukraina është e varfër demografikisht dhe ekonomikisht, me dëme të vlerësuar në 155 miliardë dollarë. Rusia ka demonstruar qëndrueshmërinë e jashtëzakonshme të popullit të saj dhe po përfiton nga euforia e një ekonomie lufte të nxitur nga shpenzimet ushtarake që arrijnë në më shumë se 6 për qind të PBB-së dhe përfaqësojnë 40 për qind të buxhetit të shtetit federal. Por ajo po shkatërron të ardhmen e saj me mërgimin e më shumë se një milion të rinjve të aftë, varfërimin e popullsisë për shkak të inflacionit, bllokimit të investimeve dhe inovacionit, përhapjen e korrupsionit dhe

forcimin e represionit.

Periodha para hapjes së negociatave do të jetë më e rrezikshme nga të gjitha, sepse do të favorizojë ekstremizmin e dhunës për t’i përballur negociatat nga pozicioni më i mirë i mundshëm.

Do të duhet një mendje e ftohtë dhe reflektim mbi kuadrin dhe përmbajtjen e negociatave, edhe në skenarin më të pafavorshëm në të cilin ato do të zhvillohen ekskluzivisht midis Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë. Objektivi i Vladimir Putinit do të jetë të ruajë 20 për qind të territorit ukrainas që ai ka pushtuar, duke parandaluar anëtarësimin e Ukrainës në NATO dhe duke kufizuar sa më shumë që të jetë e mundur garancitë e sigurisë që i jepen Kievit dhe Evropës. Donald Trumpi do të përpiqet të kufizojë përfshirjen e Shteteve të Bashkuara dhe të financojë rindërtimin e Ukrainës nga BE, duke ia besuar në të njëjtën kohë kompanive amerikane. Pozicioni i evropianëve është i paqartë. Prandaj, Franca, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Italia dhe Polonia duhet të takohen shpejt për të diskutuar dhe për të përcaktuar një pozicion mbi çështjet kritike që do të hidhen në tryezë. Armëpushimi i thjeshtë apo paqe e vërtetë?


Çfarë lëshimesh territoriale duhet të bëjë Ukraina në këmbim të garancive për sigurinë e saj (anëtarësimi në NATO, prania e ushtarëve amerikanë dhe/ose evropianë)? Si duhet të organizohet dhe financohet rindërtimi i Ukrainës, kostoja e të cilit llogaritet në 500 miliardë

dollarë? Çfarë arkitekture sigurie duhet të adoptojë Evropa për t’u përballur me Rusinë, kërcënimi ekzistencial i së cilës nuk do të zhduket me ndërprerjen e luftimeve dhe në dritën e kthesës izolacioniste dhe proteksioniste të Shteteve të Bashkuara, e cila shkon përtej personalitetit të Donald Trumpit dhe është e destinuar të zgjasë?

Rreziku kryesor mbetet ai i një lehtësimi frikacak nga ana e evropianëve, i çorientimit të tyre dhe heqjes dorë nga riarmatimi fillestar – sforcja e mbrojtjes u rrit me 31 për qind krahasuar me vitin 2021, duke arritur në 326 miliardë euro, e barabartë me 1,9 për qind të PBB-së. Në epokën e perandorive, në një botë të dhunshme ku forca mbizotëron mbi ligjin, varësia nga pikëpamja e sigurisë është e barabartë me vetëvrasjen. Cilido qoftë rezultati i luftës në Ukrainë, evropianët do të duhet të kenë parasysh se kushti për paqen me Rusinë do të mbetet krijimi i një parandalimi efektiv ushtarak kundër një sulmi të ri, ndaj të cilit nuk do të jetë më në gjendje të mbështetet vetëm tek Shtetet e Bashkuara.

Në një kohë kur tundimi për të shpërndarë dividendët e përfundimit të luftës në Ukrainë do të jetë shumë i fortë përballë kërkesave të qytetarëve për mbrojtje dhe mbingarkesës së shteteve me borxhe, riarmatimi i koordinuar i Evropës do të jetë edhe më imperativ. Ai do të përbëjë një provë vendimtare të vullnetit të qytetarëve të demokracive për të mbrojtur lirinë në shekullin e njëzet e një. / bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enverti  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Ballkani mbetet pa trajner, Pollozhani jep dorëheqje

**SUHAREKË, 4 DHJETOR** - Ballkani ka mbetur pa trajner pas eliminimit nga Kupa e Kosovës. Kampioni në fuqi pësoi humbje nga Rilindja pas ekzekutimit të penalltive dhe u eliminua në rrethin e

1/8 së finale. Humbja nga Rilindja ka bërë që trajneri Artim Pollozhani të jep dorëheqje. Ballkani e ka pranuar dorëheqjen e tij, duke i uruar suksese në të ardhmen. "Tifozë të dashur,

meqenëse rezultatet e fundit nuk përkojnë aspak me objektivat e klubit, Artim Pollozhani ka dhënë dorëheqje nga pozita e trajnerit, menjëherë pas humbjes së sotme. Duke i

uruar Pollozhanit suksese, klubi e ka pranuar dorëheqjen e tij, ndërsa gjatë ditëve vijuese do të ju njoftojmë për timonierin që do të vijë në krye të skuadrës", thuhet në njoftimin e Ballkanit.



## Peja dhe Ylli fitojnë ndeshjet e para çerekfinale të Kupës



### "Epoka e re"

**PEJË, 4 DHJETOR** - Peja e ka mposhtur Prishtinën në ndeshjen e parë çerekfinale të Kupës së Kosovës në basketboll të zhvilluar në palestrën "Karagaçi" me rezultat 74:71. Çerekfinalja zhvillohet në dy ndeshje, ku ndeshja e kthimit është pas një jave në Prishtinë. Ndeshja ishte interesante dhe me fund dramatik. Çerekun e parë e

fitoi Peja me rezultat 20:16. Prishtina u përgjigj në çerekun e dytë, të cilin e fitoi 23:21. Në pushimin e gjatë në epërsi prej dy pikësh ishte Peja, 41:39. Në çerekun e tretë Prishtina u shkëput deri në tetë pikë, 56:48, por vendasit u afruan në katër pikë, 58:54. Me të nisur çereku i katërt Peja kaloi në epërsi 59:58 me një treshe të Dardan Berishës, duke bërë që edhe në vazhdim të ruajë këtë epërsi. Tristan Ikpe ishte më i miri te Peja me 23 pikë e gjashtë kërcime, ndërsa,

Dardan Berisha shtoi 16 pikë. Te Prishtina u dallua Josh Nzeakor me 22 pikë e tetë kërcime. KB Vëllaznimi ka fituar përball Golden Eagle Yllit, në ballafaqimin që ndodhi në palestrën "Shani Nushi" në Gjakovë. Gjakovarët i mposhtën suharekasit me 18 pikë në epërsi me rezultat 100:82. Përballja e dytë mes tyre zhvillohet pas një jave në palestrën "13 qershori" në Suharekë, ku edhe do të dihet gjysmëfinalisti i Kupës së Kosovës.

## Rilindja 1974 eliminon Ballkanin nga garat e Kupës

**PRISHTINË, 4 DHJETOR** - Rilindja e Pejës është përkujdesur për befasinë e vitit në futbollin kosovar, duke eliminuar nga Kupa e Kosovës kampionin në fuqi Ballkanin. Pas 90 minutave rezultati ishte i barabartë 1-1, derisa gola nuk pati as në kohën shtesë. Fituesi u caktua pas ekzekutimit të penalltive, ku

Rilindja kaloi tutje me rezultat të përgjithshëm 10-9. Fitore pas kohës shtesë për të kaluar tutje ka shënuar edhe Suhareka ndaj Trepçës '89. 90 minutat u mbyllën baras 1-1, derisa në fund Suhareka fitoi 1-3. Tutje ka kaluar edhe Dinamo që ka eliminuar pas ekzekutimit të penalltive 0-3 ndaj 2 Korrikut.



### REZULTATET

Rahoveci - Drita	0-3
Dukagjini - Dardania	6-2
Vjosa - Drenica	0-5
Vushtrria - KEK-u	1-0
Flamurtari - Llapi	0-5
Ferizaj - Ramiz Sadiku	4-0
Mitrovica - Vëllaznimi	3-4
Gjilani - Liria	4-1

Top Football - Prishtina	1-5
Rilindja 1974 - Ballkani	1-1
(pas penalltive 10:9)	
Besa Peja - Prishtina e Re	1-2
Istogu - Feronikeli 74	1-2
Trepça'89 - Suhareka	1-1
(pas vazhdime 1-3)	
Fushë Kosova - Malisheva	0-5
2 Korriku - Dinamo	1-1
(pas penalltive 0-3)	
Kika - Trepça	2-6

## Arsenali fiton derbin ndaj Unitedit

**LONDËR, 4 DHJETOR** - Arsenali e ka fituar derbin përballë Manchester United me rezultat 2-0 të zhvilluar në kuadër të javës së 14-të në Ligën Premier. Gabriel Martinelli mendoi se kishte shënuar, por goli i tij u anulua, shkaku që më parë Kai Havertz kishte prekur topin në pozicion jashtë loje. Sulmuesi brazilian edhe në minutën e 26-të nuk kishte fat, pasi kur i bëri të gjitha, nuk arriti të fuste topin në

rrjetë. Në 45 minutat e parë, asnjëra skuadër nuk arriti të regjistronte goditje direkte në portë. Natyrisht se ishte një dominim më i lehtë nga Arsenali, me lojtarët e United që kishin më shumë detyra defanzive. Pjesa e dytë pati një tjetër fytyrë, pasi Gunners shënuan dy herë. Jurrien Timber kaloi Arsenalin në epërsi për 1-0 kur shënoi në minutën e 54-të me një asistim të Declan Rice. Rezultatit për vendasit e



dyfishoi Willam Saliba (73'), me një asistim të Thomas Parteyt, për t'i shkaktuar kështu humbjen e parë Ruben Amorimit te United. Pas javës së 14-të, Arsenali gjendet në vendin e tretë me 28 pikë, aq sa ka edhe Chelsea në të dytin, derisa Man United ka rënë në vendin e 11-të me 19 pikë. Në xhiron e 15-të, Topçinjtë takohen me Fulhamin, ndërsa Djajtë e Kuq përballen me Nottinghamin.

## Çeku: Stadiumi 'Adem Jashari' do t'i plotësojë kriteret e UEFA-s

**PRISHTINË, 4 DHJETOR** - Ministri i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Hajrulla Çeku ka publikuar pamje të reja nga punimet në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë. Ai ka

thënë se ky stadium do t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kriteret për zhvillimin e lojërave në përputhshmëri me standardet e UEFA-s dhe FIFA-s. "Po vazhdojnë punimet në

stadiumin olimpiq "Adem Jashari" në Mitrovicë. Ky stadium do të plotësojë të gjitha kushtet dhe kriteret për zhvillimin e lojërave në përputhshmëri me standardet e

UEFA-s dhe FIFA-s", ka shkruar Çeku. "Po e zbatojmë planin pesë vjeçar të infrastrukturës së futbollit, 18 komuna, mbi 20 stadione, 200 milionë euro investime", ka shtuar Çeku.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

## NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Faton Fejzullahu me nr. të protokollit 7118/23 të datës 05.12.2023 për parcelën kadastrale 00139-13, që ndodhet në Fshatin turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri" në Komunën e Prizrenit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e "Objektit për banim – turizëm fshatar" në Fshatin Turistik në Prevallë të Komunës së Prizrenit.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.11.12.2024 në: [dkp.mmph@rks-gov.net](mailto:dkp.mmph@rks-gov.net).

### Dokumentet e publikuara:

#### Kushtet Ndërtimore të propozuara

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Tokë ndërtimore	
b. Vija rregulluese.	m'
c. Vija e ndërtimit.	1.0 m 3.0 m 9.80 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	h=10.15m' d=9.8m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	h=10.15 m' d=9.60m d=2.01 m d=1.00m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	20 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	80 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	20 %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	-
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Gurë, dru dhe tullë
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

### FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës:  Furnizim  Shërbime  Punë

Nr. i Prokurimit 11-24

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org), me titullin:**

**Dosja për: Shërbime të transportit ajror**

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 2 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

#### Afatet Kohore.


Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **16.12.2024 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **18.12.2024 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **18.12.2024 ora 12:00.**

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Faton Qollaku B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër UNIK: 810347006.
- SEFEDIN HASANI, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "AZEM BEJTA", Prekaz i Epërm.
- AZHAR MAXHUNI, shpall te pavlefshme diplomën e SHMLT "ARKITEKT SINANI".
- Ibrahim Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Q.A.M.O. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Arben Nuo nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshohet banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë.
- Lëshohet banesa me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshohet me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 2138/24 të datës 04.12.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A me datë 04.12.2024 shpall:

### KONKURS PUBLIK

#### I. Titulli: Sigurim Fizik - roje

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme apo fillore

Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj

I raporton: Udhëheqësit të Njësies së Sigurimit Fizik

Lartësia e pagës mujore: 390.00Euro Bruto.

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që e kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësies së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

#### Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathtësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

#### Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

#### > Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërin nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

#### > Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

#### > Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 05.12.2024 deri me datë 19.12.2024 në ora 16:00.

#### Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 24.12.2024.

- Afati për ankesë nga data 26.12.2024 deri me datë 30.12.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 09.01.2025.
- Afati për ankesë nga data 10.01.2025 deri me datë 14.01.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 21.01.2025.
- Afati për ankesë nga data 22.01.2025 deri me datë 26.01.2025.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 02.02.2025.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

#### > Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

**Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.**

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik.

**Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.**

#### > Përfundim

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Shkëmbi" Sh.p.k Istog në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e përpunimit të gurit dekorativ të mermerizuar në Sinajë, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.01.2025 në ora 10:00 në Shtëpinë e Kulturës "Adem Jashari" komuna Istog do të organizohet debat publik nga Kompania "Shkëmbi" Sh.p.k Istog në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Shkëmbi" Sh.p.k Istog për impiantin e përpunimit të gurit dekorativ të mermerizuar në Sinajë, Istog.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnk.komente@rks-gov.net](mailto:vnk.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



2138/24  
04.12.24

U skladu s članom 8, članom 10 stav 2.2 i članom 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010. godine, u vezi s članom 7 Uputstva Administrativnog broj 01/2024 o uređivanju postupka konkursa u javnom sektoru koji je dio Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i članom 8 stav 4, članom 11, članom 21 stav 2.2 i članom 25 Pravilnika br. 55/21 o radnom odnosu NPL „Përpلامي“ Sh. A Sh. A. u Vučitrnu, usvojenog dana 21.12.2021. godine od strane Upravnog odbora NPL „Përpلامي“ Sh. A“ Sh. A., i uzimajući u obzir odluku sa brojem protokola 2138/24 od **04.12.2024**, godine od Izvršnog direktora, N.P.L. „Përpلامي“ Sh. A. **04.12.2024** objavljuje:

### JAVNI KONKURS

- I. Naziv:** Fizičko osiguranje – čuvar  
**Broj izvršitelja:** 1  
**Radno vrijeme:** 40 sati sedmično  
**Trajanje imenovanja:** Određeni period od jedne (1) godine, od kojih će šest (6) mjeseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.  
**Stručna sprema:** Srednja škola ili osnovna škola  
**Radno iskustvo:** Poželjno šest (6) mjeseci  
**Izveštava:** Rukovodilac Odsjeka za fizičko osiguranje  
**Visina mjesečne bruto plate:** 390.00€.

#### Opis poslova i odgovornosti:

- Da bude sposoban da obavlja poslove radnog mjesta u punom radnom vremenu i bez ograničenja;
- Brine o osiguranju objekta i imovine organizacije, javne institucije;
- U slučaju opasnosti odmah obavještava nadležne osobe;
- Po potrebi može biti dodijeljen na drugu lokaciju radi fizičkog osiguranja;
- Obavezan je koristiti sve predviđene zaštitne mjere na poslu;
- Da bude sposoban koristiti protivpožarnu opremu;
- Odgovoran je rukovodiocu Odsjeka za fizičko osiguranje za obavljani posao;
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

#### Posebni uslovi:

- Da bude državljanin Republike Kosovo;
- Fizička sposobnost, poželjno je da ima završene obuke iz oblasti sigurnosti;
- Poželjno je da ima licencu iz oblasti fizičkog osiguranja;

#### Uz prijavu treba dostaviti:

- Formular za prijavu N.P.L. „Përpلامي“ Sh. A - Vučitrn.;
- Dokaz o stručnoj spremi (skenirano);
- Izvod iz matične knjige rođenih; (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova će se prihvatiti)
- Potvrdu o nekažnjavanju izdatu od Stručnog vijeća Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnom krivičnom registru Republike Kosovo (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova će se prihvatiti);
- Dokaze o radnom iskustvu (skenirani) (nije obavezno);
- Kopiju lične karte (skenirano);

#### Dokumenti koji su potrebni pre uspostavljanja radnog odnosa:

- Potvrda o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Zdravstveni sertifikat.

#### ➤ Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

#### ➤ Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

#### ➤ Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja istog. Objava je otvorena od datuma **05.12.2024** do datuma **19.12.2024** u 16:00 sati.

#### Približni kalendar postupka regrutacije:

- Verifikacija unapred aplikacija kandidata najkasnije do **24.12.2024**.
- Rok za prigovor od **26.12.2024** do **30.12.2024**.
- Period kandidata kada će biti podvrgnuti pisanom testu, i kada će se vršiti njihova evaluacija, biće najkasnije do **09.01.2025**.
- Rok za prigovor od **10.01.2025** do **14.01.2025**.
- Period kandidata kada će biti podvrgnuti usmenom intervjuu, i kada će se vršiti njihova evaluacija, biće najkasnije do **21.01.2025**.
- Rok za prigovor od **22.01.2025** do **26.01.2025**.
- Objavljivanje konačnih rezultata u vezi sa uspešnim kandidatom biće najkasnije **02.02.2025**

Narativni kalendar postupka regrutacije može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je podneta žalba ili ne, i u zavisnosti od rada ocenjivačke komisije i odeljenja za kadrove. U svim slučajevima kada se podnese žalba u bilo kojoj fazi postupka regrutacije, žalba će imati suspenzivni efekat dok se ista ne razmotri od strane Komisije za žalbe.

#### ➤ Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavi formular u Arhivu NPL "Përpلامي" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

**Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: [hrperparimi@gmail.com](mailto:hrperparimi@gmail.com).**

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaće se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

**Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.**

#### ➤ ZAKLJUČAK

N.P.L. "Përpلامي" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Fasaderi ia" SH.P.K. me seli në Viti, pronar Izri Ahmeti ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811550492 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Fasaderi ia" D.O.O. Viti, Izri Ahmeti donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811550492 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Fasaderi ia" L.L.C. with headquarters Viti, Izri Ahmeti has come to the decision to quit its business: 811550492 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

